Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar i Avancuar

P9

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 15.07.2023

1. Geb sh.a është një kompani e listuar në bursë dhe ka investime në dy kompani të tjera si në vijim:

a. 70% të aksioneve të zakonshme në Sobek sh.a të blera në datën 1 janar 2018
b. 10% të aksioneve të zakonshme në Shu sh.a të blera në datën 31 korrik 2016

Në datën 31 korrik 2016 Sobek sh. a. bleu 60% të Shu sh.a.

Pasqyrat e pozitës financiare të të tre kompanive në datën 31 dhjetor 2022 janë si më poshtë:

	Geb sh. a	**Sobek sh.a**	**Shu sh.a**
	€'000	**€'000**	**€'000**
Pasuritë jo – qarkulluese:			
Pasuri e patund., impi.e prodh.dhe pajisjet	3,220	1,100	940
Investime në Sobek sh.a	1,000	–	–
Investime në Shu sh.a.	90	220	–
	4,310	1,320	940
Pasuritë qarkulluese:			
Stoqet	730	315	225
Të arkëtueshmet tregtare	412	124	97
Para e gatshme	120	25	123
	1,262	464	445
Total pasuritë	**5,572**	**1,784**	**1,385**
Ekuiteti:			
Kapitali aksionar i zakonshëm	700	280	150
Premitë e aksioneve	200	120	50
Fitimet e mbajtura	2,800	1,140	655
	3,700	1,540	855
Detyrimet afat – gjata			
Kredi bankare	1,523	157	165
Detyrimet afat - shkurtra			
Të pagueshmet tregtare	349	87	365
Total ekuiteti dhe detyrimet	**5,572**	**1,784**	**1,385**

Informatat në vijim janë të rëndësishme:

i) Gjatë vitit, Sobek sh.a. i shiti mallra Shu sh.a me vlerë €250,000 përfshirë një marzhë prej 25% mbi kosto. Të gjitha këto mallra kishin mbetur në stoqe në fund të vitit.

ii) Fitimet e mbajtura të tre kompanive mund të përmblidhen si më poshtë:

	31 korrik 2016	**1 janar 2018**
	€'000	**€'000**
Geb sh. a	1,400	2,200
Sobek sh. a	500	1,000
Shu sh.a	50	200

iii) Vlerat në libra të pasurive neto të identifikueshme në datën e blerjës janë ekuivalent me vlerat e tyre të drejta. Vlera e drejtë e 10% pronësi të Geb sh.a në Shu sh.a me 1 janar 2018 ishte €70,000.

iv) Geb sh.a dhe Sobek sh.a mbajnë investimet e tyre në filial sipas kostos në pasqyrat e veçanta financiare. Është politikë e grupit të vlerësoj interesat jo-kontrollues sipas vlerës së drejtë në blerje. Drejtorët vlerësuan interesat jo-kontrollues në Sobek sh.a €525,000 dhe në Shu sh.a me €180,000 me 1 janar 2018.

v) Nuk ka humbje prej dëmtimeve në pasqyrat e konsoliduara financiare deri më sot.

Kërkohet:

Përgatisni pasqyrën e e konsoliduar të pozitës financiare të grupit Geb sh. a për datën 31 dhjetor 2022. (25 pikë)

1. **Grupi Geb sh.a**

Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare me 31 dhjetor 2022

	€'000
Pasuritë jo – qarkulluese	
Pasuri e patund., impi.e prodh.dhe pajisjet (3,220 + 1,100 + 940)	5,260
Zëri i mirë (Ll2)	129
	5,389
Pasuritë qarkulluese:	
Stoqet (730 + 315 + 225 – (Ll5) 50)	1,220
Të arkëtueshmet tregtare (412 + 124 + 97)	633
Paraja (120 + 25 + 123)	268
	2,121
	7,510
Ekuiteti:	
Kapitali aksionar i zakonshëm	700
Premitë e aksioneve	200
Fitimet e mbajtura (Ll3)	3,080
	3,980
Interesat jo-kontrollues (Ll4)	884
	4,864
Detyrimet afat – gjata	
Kredi bankare (1,523 + 157 + 165)	1,845
Detyrimet afat - shkurtra	
Të pagueshmet tregtare (349 + 87 + 365)	801
	7,510

Llogaritjet

1 Struktura e grupit

Geb sh.a

1 janar 2018 70%

Rezervat para blerjes:

1 janar 2018 1,000,000

31 korrik 2016 Sobek sh.a 10%

Rezervat para blerjes:

1 janar 2018 200,000

31 korrik 2016 Shu sh.a 60%

Interesi efektiv (70% × 60%) + 10%	52%
Interesat jo-kontrollues	48%
	100%

2. Zëri i mirë

	Geb sh.a në Sobek sh.a		Sobek sh.a në Shu sh.a	
	€'000	€'000	€'000	€'000
Konsiderata e transferuar		1,000	(220 x 70%)	154
Vlera e drejtë e interesave jo-kontrollues		525		180
Vlera e drejtë e interesi 10% në Shu sh.a				70
Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme:				
Aksionet e zakonshme	280		150	
Premia e aksioneve	120		50	
Fitimet e mbajtura para blerjes (1 janar 2018)	1,000		200	
		(1,400)		(400)
		125		4
			129	

3. Fitimet e mbajtura

	Geb sh.a	Sobek sh.a	Shu sh.a
	€'000	€'000	€'000
Sipas pyetjes	2,800	1,140	655
F/H humbja në investimet në Shu sh.a (70 – 90)	(20)		
Minus: fitimi i parealizuar (Ll5)		(50)	
Fitimet e mbajtura në blerje (L2)		(1,000)	(200)
		90	455
Pjesa e grupit e fitimeve pas blerjes:			
Sobek sh.a (90 x 70%)	63		
Shu sh.a (455 x 52%)	237		
Pjesa e grupit e humbjve nga dëmtimi	(0)		
	3,080		

4. Interesat jo-kontrollues

	Sobek sh.a	Shu sh.a
	€'000	€'000
IJK në blerje (Ll2)	525	180
Pjesa e fitimeve të mbajtura pas blerjes e IJK-së:		
Sobek sh.a (90 x 30%)	27	
Shu sh.a (455 x 48%)		218
Minus: Pjesa e IJK-së në investimet në Shu sh.a (220 x 30%)	(66)	
	486	398
	884	

5. Fitimi i parealizuar në stoqe

Marzha mbi kosto = €250,000 × 25/125 = €50,000

2.

a) Më 9 korrik 2009, BSNK-ja publikoi SNRF për NVM-të. Ky është grupi i parë i kërkesave kontabël ndërkombëtare të zhvilluara posaçërisht për ndermarrjet të vogla dhe të mesme (NVM). Ai është përgatitur në bazë të SNRF-ve, por është një produkt i pavarur që është i ndarë nga grupi i plotë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Kërkohet:

Diskuto parparësitë dhe të metat për NVM që ndjekin SNRF-në për NVM në krahasim me SNRF-të e plota. (10 pikë)

b) SNK 12 *Tatimet në fitim* zbaton një të ashtuquajtur "Metoda e provizioneve të plota" të kontabilitetit për tatimet mbi të ardhurat, e cila njeh si pasojat aktuale tatimore të transaksioneve dhe ngjarjeve, ashtu edhe pasojat e ardhshme tatimore të rikuperimit ose shlyerjes së ardhshme të vlerës kontabël të pasurive dhe detyrimeve të një entiteti.

Kërkohet:

Shpjegoni se çfarë nënkuptojnë termat "përqëndrimi në pasqyrën e pozicitës financiare" dhe "diferencat e përkohshme"në lidhje me tatimin e shtyrë. (5 pikë)

2.

a)

Përparësitë

Edhe pse Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) fillimisht u krijuan për të qenë të përshtatshëm për të gjitha llojet e entiteteve, në vitet e fundit SNRF-të janë bërë gjithnjë e më komplekse. Tani ato janë krijuar kryesisht për të përmbushur nevojat për informacion të investitorëve institucionalë në entitetet e mëdha të listuara.

Aksionarët e NVM-ve janë shpesh edhe drejtorë. Prandaj, përmes menaxhimit të kompanisë dhe duke mbajtur të dhënat financiare, ata tashmë janë të vetëdijshëm për performancën dhe pozitën financiare të kompanisë dhe kështu nuk kanë nevojë për nivelin e detajeve në pasqyrat financiare të kërkuara nga investitorët institucionalë të jashtëm të kompanive më të mëdha.

Përdoruesit kryesorë të jashtëm të NVM-ve priren të jenë huadhënësit, furnitorët tregtarë dhe autoritetet tatimore. Ata kanë nevoja të ndryshme nga investitorët institucionalë dhe kanë më shumë gjasa të fokusohen flukset monetare afatshkurtër, likuiditetin dhe aftësinë paguese.

SNRF-të e plota mbulojnë një gamë të gjerë çështjesh, përmbajnë një sasi të konsiderueshme udhëzimesh për zbatimin dhe përfshijnë kërkesat e dhënies së informacioneve të përshtatshme për kompanitë publike. Kjo mund t'i bëjë edhe ato komplekse për t'u kuptuar nga përdoruesit e NVM-ve.

Shumë NVM mendojnë se ndjekja e SNRF-ve të plota vendos një barrë të papranueshme për përgatitësit e pasqyrave të NVM-ve – një barrë që ka ardhur duke u rritur ndërsa SNRF-të bëhen më të detajuara dhe më shumë vende adoptojnë ato. Kostoja e ndjekjes së SNRF-ve të plota shpesh duket se tejkalon përfitimet.

Kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të SNRF-ve të plota janë shumë të gjera dhe si të tilla mund të rezultojnë në mbingarkesa e informacionit për përdoruesit e pasqyrave të NVM-ve, duke reduktuar kuptueshmërinë financiare tw pasqyrave.

Disa SNRF ende ofrojnë zgjedhje të trajtimeve kontabël, duke çuar në mungesë krahasueshmërie ndërmjet tyre kompani të ndryshme duke adoptuar standarde të ndryshme kontabël.

Disavantazhet

Nëse NVM-të ndjekin SNRF-të e tyre të thjeshtuara, pasqyrate tyre nuk janë më të krahasueshme me pasqyrat e kompanive të mëdha që ndjekin SNRF-të e plota ose me NVM-të që zgjedhin të ndjekin SNRF-të e plota. Kjo mund ta bëjë atë më e vështirë për të tërhequr investitorë.

Kalimi nga SNRF të plota në SNRF të thjeshtuara për NVM-të, do të kërkojë trajnim dhe është i mundur ndryshimet në sisteme. Kjo do të vendosë një barrë në kohë dhe kosto për kompaninë.

SNRF-të e plota tani janë krijuar dhe respektuar mirë dhe veprojnë si një formë e kontrollit të cilësisë në pasqyrat financare që janw nw pajtueshmwri me to. Prandaj mund të argumentohet

se pasqyrat financiare të cilat nuk janë më në përputhje me SNRF-të e plota do të humbasin besueshmërinë e tyre.

SNRF për NVM-të redukton në mënyrë thelbësore dhënien e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga SNRF-të e plota. Mos-shpalosja e disave informacioneve kryesore mund t'i bëjë pasqyrat financiare më të vështira për t'u kuptuar.

b)

SNK 12 fokusohet në pasqyrën e pozitës financiare në kontabilizimin për tatimin e shtyrë. Ai bazohet në parimin që një detyrim ose pasuri tatimore e shtyrë duhet të njihet nëse rikuperimi i vlerës kontabël të pasurisë ose shlyerja e detyrimit do të rezultojë në pagesa tatimore më të larta ose më të ulëta në të ardhmen sesa do të ishte rasti nëse rikuperimi ose shlyerja nuk do të kishte pasoja tatimore. Pasojat e ardhshme tatimore të ngjarjeve të kaluara përcaktojnë detyrimet ose pasuritë tatimore të shtyra. (SNK 12 jep disa përjashtime nga ky rregull i përgjithshëm, p.sh. tatimi i shtyrë nuk parashikohet mbi zërin e mirë.) Llogaritja e saldove tatimore të shtyra përcaktohet duke parë diferencën midis bazës tatimore të një pasurie dhe vlerës kontabël të tij në pasqyrën e pozicitës financiare. Kështu llogaritja fokusohet në pasqyrën e pozicitës financiare.

Diferencat midis vlerës kontabël të pasurisë dhe detyrimitdhe bazës së tij tatimore quhen 'diferencat e përkohshme'. Fjala 'i përkohshëm' përdoret sepse është një propozim themelor në kuadrin e SNK-së që një entitet do të realizojë pasuritë e tij dhe do të shlyejë detyrimet e tij me kalimin e kohës, në momentin kur pasojat tatimore do të kristalizohen. Objektivi i metodës së diferencës së përkohshme është të njohë pasojat e ardhshme tatimore të qenësishme në vlerat kontabël të pasurive dhe detyrimeve në pasqyrën e pozitës financiare. Qasja shikon tatimin e pagueshëm nëse pasuritë dhe detyrimet janë realizuar për shumat para tatimit të regjistruara në pasqyrën e pozitës financiare. Prezupozimi është se do të ketë rikuperim të zërave të pasqyrës së pozitës financiare nga të ardhurat e ardhshme dhe duhet të sigurohet taatim në lidhje me një rikuperim të tillë. Kjo përfshin vështrimin e diferencave të përkohshme ndërmjet vlerës kontabël të pasurive dhe detyrimeve dhe bazës tatimore të elementeve. Standardi njeh dy lloje diferencash të përkohshme, të cilat përshkruhen si diferenca të përkohshme 'të tatueshme' dhe 'të zbritshme'.

Diferenca të përkohshme të tatueshme, janë diferencat e përkohshme të cilat do të rezultojnë në vlera të tatueshme gjatë përcaktimit të fitimeve të tatueshme (humbjeve tatimore) në periudhat e ardhshme kur të realizohet vlera bartëse e pasurisë ose të shlyhet vlera bartëse e detyrimit.

Diferencat e përkohshme të zbritshme, të cilat janë diferencat e përkohshme të cilat do të rezultojnë në vlera të zbritshme gjatë përcaktimit të fitimeve të tatueshme (humbjeve tatimore) në periudhat e ardhshme.

3.

(a) Seth sh.a përfundoi ndërtimin e një fabrike për prodhimin e pjesëve të ndryshme të automjeteve më 31 mars 2022 me një kosto prej €2,100,000. Në të njëjtën datë, ajo bleu një paisje me një kosto prej €500,000.

Më 31 dhjetor 2022, fabrika u dëmtua nga vershimet. Paisja është dëmtuar në masën e duke e bërë të padobishme për Seth sh.a. Megjithatë, dëmtimi i fabrikës ishte jomaterial. Seth sh.a synon të shesë paisjen e dëmtuar dhe ka caktuar çmimin në €200,000. Ajo kishte një vlerë të drejtë neto prej €80,000 më 31 dhjetor 2022. Paisja e dëmtuar u zëvendësua më 31 dhjetor 2022 me një kosto prej €520,000.

Seth sh.a ende nuk ka bërë asnjë përpjekje për të gjetur një blerës të pasijes së dëmtuar deri me 31 dhjetor 2022.

Është politikë e Seth sh.a që t'i zhvlerësojë këto paisje dhe fabrikën me një normë vjetore prej 20% dhe 5% respektivisht duke përdorur metodën lineare.

Vlera e mbetur e fabrikës dhe paisjeve është zero dhe nuk janë të siguruara.

Kërkohet:

Këshilloni Seth sh.a se si duhet të trajtohet transaksioni i mësipërm në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. (10 pikë)

(b)

Ju jeni një trajnues që mban seminare mbi tema të ndryshme për Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar në Shoqatën e Kontabiliztëve dhe Auditorëve të Çertifikuar të Kosovës (ShKÇAK). Javën e ardhshme do të keni një prezantim mbi "Njohja e të hyrave në kontratat me konsumatorët" në ShKÇAK. ShKÇAK-u dëshiron të shikojë prezantimin tuaj sot përpara se të dorëzohet javën e ardhshme.

Kërkohet:

Shkruani shënime të shkurtra mbi prezantimin "Njohja e të hyrave në kontratat me konsumatorët" që do t'i dorëzohen ShKÇAK-ut. (10 pikë)

a)

Fabrika

Fabrika do të shfaqet me një vlerë kontabël prej €2,021,250 (shih LL1) më 31 dhjetor 2022 në pasqyrën e pozitës financiare. Zhvlerësimi për periudhën nëntë mujore prej €78,750 (shih LL1), e cila do të paraqitet në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022.

Paisja

Dëmi i shkaktuar nga vërshimet është një tregues i dëmtimit. Prandaj duhet të rishikohet për dëmtim më 31 dhjetor 2022. Në atë datë paisja ka një vlerë kontabël prej €425,000 (500,000 – 75,000) pas zbritjes së zhvlerësimi prej €75,000 (20% x 500,000 x 9/12). Shuma e rikuperueshme e saj është më e larta midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes prej €80,000 dhe vlerës në përdorim zero. Vlera në përdorim është zero pasi është e padobishme për Seth sh.a dhe nuk ka për qëllim përdorimin e saj. Prandaj, shuma e saj e rikuperueshme është €80,000 në përputhje me SNK 36 *Dëmtimi i pasurive*. Vlera kontabël e paisjes është më shumë se shuma e saj e rikuperueshme për €345,000 (425,000 – 80,000) që përfaqëson humbjen e saj nga dëmtimi.

Shuma totale që do të paraqitet në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 është €420,000, e përbërë nga zhvlerësimi prej €75,000 dhe humbja nga dëmtimi prej €345,000. Pasija do të paraqitet në pasqyrën e pozitsës financiar më 31 dhjetor 2022 në €80,000 si pjesë e pronës, impianteve dhe pajisjeve që i nënshtrohen zhvlerësimit. Pasija nuk duhet të klasifikohet si 'e mbajtur për shitje' sepse nuk i ka plotësuar kushtet e parashikuara në SNRF 5 *Pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera*. Seth sh.a ka caktuar çmimin e saj të shitjes në €200,000, që është më shumë se vlera e drejtë neto e saj prej €80,000. Kjo e bën pasijen më pak gjasa për t'u shitur. Më tej, Seth sh.a nuk ka bërë asnjë përpjekje për të gjetur blerësin.

Pasija e re

Kjo do të paraqitet tek pasuritë jo-qarkulluese me vlerë kontabël prej €520,000. Nuk do të ngarkohet zhvlerësim pasi është blerë në datën e raportimit.

Llogaritja 1 - Fabrika

	€'000
Kosto me 31 mars 2022	2,100
Zhvlerësimi 5% x 2,100 x 9/12	(78.75)
Vlera e bartur me 31 dhjetor 2022	**2,021.25**

Llogaritja 2 - Paisja

	€'000
Kosto me 31 mars 2022	500
Zhvlerësimi 20% x 500 x 9/12	(75)
Vlera e bartur me 31 dhjetor 2022	425
Shuma e rikuperushme	80
Humbja nga demtimi	(345)
Vlera e bartur me 31 dhjetor 2022	**80**

b) Shënime për ShKÇAK

Hapi 1 - Identifiko kontratat me konsumatorët.

Identifikimi i një kontrate është zakonisht shume e thjeshtë, pasi që do të ketë një marrëveshje të shkruar apo ndonjë alternative tjetër sipas praktikave të biznesit. Entiteti zakonisht do të trajtonte kontratën ndarazi, por ka raste kur mind të i kombinojnë ato. Pika kyqe është ndërvarësia çmimore. Zakonisht një kompani do të aplikonte propozimet për një kontratë. Megjithatë, në disa raste kompania do të merrte parasysh dy apo më shumë kontrata së bashku nëse çmimet e atyre kontratave jane në ndërvarësi. Në të kundërtën, një kompani do të ndante një kontratë të vetme dhe do ta merrte parasysh si dy apo më shumë kontrata nëse disa mallra apo shërbime janë çmimuar pavarësisht nga mallrat dhe shërbimet tjera.

Hapi 2 - Identifiko obligimet e ndara të përformancës.

Pika kyqe është mallrat apo shërbimet e dallueshme, Një kontratë përfshinë permtimin për të siguruar mallra apo shërbime ndaj një klienti. Ato premtime quhen obligime të përformancës. Një kompani do të mbante llogari për obligimin e përformancës ndarazi vetëm nëse mallrat apo shërbimet e premtuara dallohen. Një mall apo shërbim është i dallueshëm nëse shitet ndarazi apo mund të shitet veçmas sepse ka një funksion të dallueshëm dhe marzhë të fitimit të dallueshme.

Hapi 3 - Përcakto çmimin e transaksionit.

Propozimi kyq është shuma e pritur e pëshuar sipas probabilitetit. Çmimi i transaksionit do të reflektonte vlerësimet e bazuara në probabilitet të kompanisë të konsideratave të ndryshme (përfshirë vlerësime të arsyeshme të shumave kontigjente) përveq efekteve te rrezikut kreditor të klientit dhe vlerën në kohë të parasë (nëse është materiale).

Hapi 4 - Aloko çmimin e transaksionit për onligimet e përformancës.

Propozimi kyq është alokimi relative i çmimit shitës. Një kompani do të alokonte çmimin e transaksionit tek të gjitha obligimet e ndara të përformacës në proporcion me çmimin e shitjes të vetëm mallit apo shërbimit që i përket obligimi i përformancës. Nëse malli apo shërbimi nuk shitet ndarazi, kompania do të vlerësonte çmimin shitës ndarazi të tij.

Hapi 5 - Njih të hyrat kur obligimi ndaj përformancës është përmbushur.

Një kompani do të njihte të hyrat kur të përmbush një obligim të përformancës duke transferuar mallin apo shërbimin e premtuar tek klienti. Malli apo shërbimi është transferuar kur konsumatori merr kontrollin e mallit apo shërbimit të premtuar. Një tregues i kësaj është kur konsumatori ka rrezikun dhe shpërblimet e pronësisë.

Shuma e të hyrave e njohur është shuma e alokuar tek ai obligim i përformancës në Hapin 4.

4. Horus sh.a mirret me shitjet e frutave dhe perimeve. Është krijuar ne vitin 2022. Më posht janë paraqitur pasqyrat financiare të Horus sh.a për vitet e përfunduara me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2022.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse

	2022	**2021**
	€'000	**€'000**
Të hyrat	1,700	1,500
Kosto e shitjeve	(1,100)	(1,000)
Fitimi bruto	600	500
Të hyrat tjera	150	120
Kosto e shpërndarjes	(200)	(150)
Shpenzimet administrative	(140)	(120)
Kosto financiare	(15)	(25)
Fitimi para tatimit	395	325
Tatimi	(40)	(33)
Fitimi për periudhën	**355**	**292**
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		
Përfitimi nga rivlerësimi	80	-
Neto fitimet dhe humbjet nga vlerësimet e ekspertëve	25	20
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse	**460**	**312**

Pasqyra e pozitës financiare

	2022	**2021**
	€'000	**€'000**
Pasuritë		
Pasuritë jo-qarkulluese:		
Pasuri e patund., impi.e prodh.dhe pajisjet	1,316	1,054
Investimet në pasuri të patundshme	463	162
Pasuritë e patrupëzuara	234	262
Pasuritë financiare	56	42
	2,069	1,520
Pasuritë qarkulluese:		
Stoqet	169	147
Tëarkëtueshmet tregtare	216	315
Paraja	-	41
	385	503
Total pasuritë	**2,454**	**2,023**
Ekuiteti dhe detyrimet		
Ekuiteti		
Aksionet e zakonshme prej €0.50 secila	850	700
Komponentë të tjerë të ekuitetit	125	20
Fitimet e mbajtura	520	215
	1,495	935

Detyrimet afat – gjata		
Përfitimet e punonjësve	254	315
Tatimi i shtyrë	181	163
20% Kredi	75	125
	510	603
Detyrimet afat - shkurtra		
Të pagueshmet tregtare	299	353
Tatimi	48	96
Interesi i pagueshëm	52	36
Mbitërheqja bankare	50	-
	449	485
Total detyrimet	959	1,088
Total ekuiteti dhe detyrimet	**2,454**	**2,023**

Informata shtesë:

i) Horus sh.a rivlerësoi ndërtesën më 31 dhjetor 2022 për herë të parë. Kjo ishte si pasojë e ndryshimit të politikës së saj nga modeli i kostos në modelin e rivlerësimit të SNK 16 *Pasuritë e Patundshme, Impiantet dhe Pajisjet.*

ii) Horus sh.a ka paguar totalin e dividentëve prej €50,000 në vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022 dhe €25,000 në vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022.

iii) Inormatat jo-financiare:

	2022	**2021**
Numri i klientëvë	2.8 milion	2.5 milion
Numri i punonjësve	960	840
Numri i pikave të shitjes	12	10

iv) Horus sh.a emetoi aksione të zakonshme me 1 janar 2022.

Kërkohet:

Shkruani një raport bordit të drejtorëve që vlerëson pozitën dhe performancën financiare të Horus sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022. (Përgjigja juaj duhet të përfshijë llogaritjet përkatëse). (20 pikë)

Për: Bordin e drejtorëvë – Horus sh.a
Nga: Kontabilisti
Data: 15 korrik 2022
Tema: Vlerësimi i pozitës dhe performancës të Horus sh.a

Hyrje

Vlerësimi i pozitës dhe performancës së Horus sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 është bazuar në informacionin financiar dhe jofinanciar për dy vjet. Analiza e koeficientëve të përdorur bazohet në koeficientët e llogaritur në shtojcë.

Vlerësimi i pozitës dhe performancës

Profitabiliteti dhe rritja e të hyrave

Të ardhurat janë rritur me 13.33% megjithëse numri i klientëve është rritur vetëm me 12%. Kjo tregon se Horus sh.a mund të ketë ulur pak çmimin e shitjes për të tërhequr dhe të mbajë klientët ekzistues.

Marzha e fitimit bruto është rritur pak nga nga 33.33% deri në 35.29%. Në mënyrë të ngjashme, marzhi i fitimit operativ u rrit nga 23.33% në 24.12%%.Këto tregojnë një prirje rritwse në profitabilitetin dhe performancën e përgjithshme të kompanisë. Kjo vërtetohet nga vendimi i kompanisë për të rritur numrin e punës fuqia nga 860 punonjës në 940 punonjës dhe rritjen e pikave të shitjes nga 10 në 12.

Norma e kthimit mbi kapitalin e angazhuar ka shfaqur një tendencë rënëse. Është zvogëluar nga 22.76% në 20.45% Kjo mund t'i atribuohet një rivlerësimi pozitiv të pasurive të patundshme.

Likuiditeti dhe kapitali qarkullues

Koeficienti qarkullues ka shënuar rënë nga 1.04 në 0.86. Gjithashtu edhe koeficienti i shpejtë ka rënë nga 0.73 në 0.48. Të dy koeficientë tregojnë se pasuritë qarkulluese të Horus sh.a nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar detyrimet afatshkurtëra.

Qarkullimi i stoqeve është ngadalësuar nga 54 ditë në 56 ditë. Ky është një tregues i ngadalësimit të nivelit të aktivitetit të biznesit, por periudha e arkëtimit për të arkëtueshmet tregtare u përshpejtua nga 77 ditë në 46 ditë.

Llogarite e pagueshme paguhen meatarisht 99 ditë në krahasim me 129 ditë në vitin 2021.

Koeficientët e leverazhit

Hyrja në borxh në terma relativ është përmirësuar nga 11.79% në 4.77%. Borxhi është zvogëluar edhe në terma abosult gjithashtu nga €125,000 në €75,000 apo për 40%.

Gjithashtu, mbulimi i interesit është rritur nga nga 14 herë në 27.33 here. Kjo i atribuohet një reduktimi të kostos së interesit dhe rritjes së rentabilitetit të kompanisë. Kostoja e interesit është zogëluar për 40% nga €25,000 në €15,000 si rezultat i zvogëlimit të borxhit. Kjo mund të tregojë nivelin e ulët të rrezikut financiar dhe aftësisë së pagesës së detyrimeve.

Koeficientët e investitorëve

Fitimet për aksion të kompanisë kanë mbetur të njejta në 21 cent. Rritja e fitimeve nuk ka kontribuar në rritjen e Fitimit për aksion pasi qe është rritur edhe numri i aksioneve në të

njejtën kohë. Megjithatë dividenta për aksion u rrit nga €0.017 në €0.03 dhe mund të jetë e qendrueshme duke pasur parasysh koeficientin e mbulimit të dividendës i cili është rritur nga 5.84 here në 7.1 herë .

Konkluzion

Pozita dhe performanca financiare është përmirësuar por menaxhmenti duhet të trajtoj me prioritet aftësinë paguese afatshurtër (likuiditetitin). Megjithatë, është me rëndësi të madhe të shikohet edhe industria dhe koeficientët e saj për të konstatuar pozitën dhe performancën e Horus sh.a.

Shotjca

Koeficientët e profitabilitetit
Përqindja e rritjes së të hyrave 2022
(1,700-1,500) /1,500 = 13.33%

Përqindja e rritjes së klientëvë 2022
(2,800,000-2,500,000) /2,500,000= 12.00%

	2022	2021
Marzha e fitimit bruto		
Fitimi bruto/të hyrat		
600/1,700	35.29%	
500/1,500		33.33%

Marzha e fitimit operativ	2022	2021
Fitimi para interesit dhe tatimit /të hyrat		
(395+15)/1,700	24.12%	
(325+25)/1,500		23.33%

Norma e kthimit mbi kapitalin e angazhuar	2022	2021
Fitimi para interesit dhe tatimit /Kapitalin a angazhuar		
(395+15)/(1,495+510)	20.45%	
(325+25)/ (935+603)		22.76%

Qarkullimi i pasurive		
Të hyrat /Kapitalin a angazhuar		
1,700 / (1,495+510)	0.85 here	
1,500 / (935+603)		0.98 here

Koeficientët e likuiditetit dhe kapitalit qarkullues	2022	2021
Koeficienti qarkullues		
Pasuritë qarkulluese / detyrimet afatshkurtëra		
385 / 449	0.86	
503 / 485		1.04
Koeficienti i shpejtë		
(Pasuritë qarkulluese – stoqet) / detyrimet afatshkurtëra		
(385 -169) / 449	0.48	
(503 -147) / 485		0.73

Periudha e qarkullimit të stoqeve
Stoqet / Kosto e shitjeve x 365

169/ 1,100 x 365	56 ditë	
147 / 1,000 x 365		54 ditë

Periudha mesatare e arkëtimit	2022	2021
LL/A / shitjet x 365		
216/ 1,700 x 365	46 ditë	
315 / 1,500 x 365		77 ditë

Periudha e pagesës së llogarive të pagueshme
LL/P/ Kosto e shitjeve x 365

299 / 1,100 x 365	99 ditë	
353 / 1,000 x 365		129 ditë

Koeficientët e leverazhit

Hyrja në borxh = Borxhi nga interesi/ (Ekuiteti i aksionarëve + Borxhi nga interesi) x 100

75 / (75 +1,495)	4.77%	
125 / (125 + 935)		11.79%

Mbulesa e interesit = Fitimi para interesit dhe tatimit / Interesi i pagueshëm

(395+15)/ 15	27.33 here	
(325+25)/ 25		14 here

Koeficientët e investitorëve	2022	2021
Fitimi për aksion = Fitimi qe iu takon aksioanreve të zakonshëm / Numrin mesatar të ponderuar të aksioneve		
355 / 1,700	0.21	
292/ 1,400		0.21
Mbulimi i dividendës = Fitimi qe iu takon aksioanreve të zakonshëm / Dividenden e paguar		
355 / 50	7.1 here	
292/ 25		5.84 here
Dividenda për aksion = Dividenda e paguar / Numri i aksoneve		
50 / 1,700	0.03	
25/ 1,400		0.017

5.

a) Një pasuri shitet në dy tregje aktive, Tregun e Prishtinës dhe Tregun e Tiranës, për €80 dhe €82, përkatësisht. Nephthys sh.a bën biznes në të dy tregjet dhe ka qasje në çmimet në ato tregje për pasurinë në datën e matjës si në vijim.

	Prishtina	**Tirana**
	€	**€**
Çmimi	80	82
Kostot e transaksionit	(4)	(3)
Kostot e transportit (për të transportuar pasurinë në atë treg)	(3)	(4)
	73	**75**

Kërkohet:

Duke përdorur informata më sipër tregoni vlerën e drejtë të pasurisë së kompanisë Nephthys sh.a me të cilën do të vlerësohet pasuria në pajtim me SNRF 13 *Matja e vlerës së drejtë* duke supozuar së:

i. Prishtina është tregu kryesor. (2 pikë)

ii. as Prishtina e as Tirana nuk është tregu kryesor për pasurinë. (4 pikë)

b) Sipas SNRF 13 *Matja e vlerës së drejtë* entitetet mund të përdorin më shumë se një teknikë të vlerësimit për të matur vlerën e drejtë në një situatë të caktuar.

Kërkohet:

Shpjegoni qasjet në vlerësim të identifikuara nga SNRF 13 *Matja e vlerës së drejtë.* (4 pikë)

c) Nemty sh.a, viti i të cilit përfundon me 31 dhjetor 2022 ka një filial, Nut sh.a, të cilin e ka blerë në faza. Detajet e blerjës janë si në vijim.

Data e blerjës	**Pjesa e blerë**	**Fitimet e mbajtura në blerje**	**Konsiderata e blerjës**
	%	**€m**	**€m**
1 janar 2021	20	150	160
1 janar 2022	40	250	520

Kapitali aksionar i Nut sh.a ka mbetur i pandryshuar që nga themelimi në €200m. Vlera e drejtë e neto pasurive të Nut sh.a ishte e njejtë si vlera bartëse në datën e blerjës. Nemty sh.a nuk kishte ndikim domëthënës në Nut sh.a në çfarëdo kohe para marrjës së kontrollit të Nut sh.a. Është politike e grupit të masë interesin jo-kontrollues sipas pjësës proporcionale të vlerës së drejtë të neto pasurive të identifikueshme të filialit. Nuk ka dëmtim të zërit të mirë.

Kërkohet:

i. Llogarite zërin e mirë në blerje të Nemty sh.a që do të paraqitet në pasqyrën e konsoliduar financiare me 31 dhjetor 2022. (5 pikë)

ii. Llogarite fitimin në mosnjohjën e çdo investimi të mbajtur më herët në Nut sh.a që do të raportohet në fitimin ose humbjën e grupit për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022. (5 pikë)

5. a) Vlera e drejtë nuk korrigjohet për kosto të transaksionit. Sipas SNRF 13, këto nuk janë veçori të pasurisë apo detyrimit, por mund të mirren parasysh kur të përcaktojmë tregun më të avancuar.
i) Nëse Prishtina është tregu kryesor për pasurinë pra tregu më vëllimin më të madh dhe nivel të aktivitetit për pasurine, vlera e drejtë e pasurisë do të ishte €77, e matur si çmimi që do të pranohej në atë treg (€80) minus kostot e transporti (€3) duke injoruar kostot e transaksionit.

ii) Nëse as Prishtina e as Tirana nuk është tregu kryesor për pasurinë, Nephthys sh.a duhet të masë pasurinë duke përdorur çmimin në tregun më të avancuar. Tregu më i avancuar është tregu që maksimizon shumën që do të pranohej për ta shitur pasurinë, pasi që të mirren parasysh edhe kostot e transaksionit edhe të transaportit pra shuma neto që do të pranohej në tregjet përkatëse.

Shuma maksimale neto pas zbritjes se kostove të transaksionit dhe të transportit miret në tregun e Tiranës €75, e jo në Prishtinë €73. Por kjo nuk është vlera e drejtë e pasurisë. Vlera e drejtë e pasurisë mirret duke zbritur kostoto e transportit por jo kostot e transaksionit nga çmimi i pranuar në tregun e Tiranës: €82 - €4 = €78.

b)
SNRF identifikon tri qasje në vlerësimit:

- **Qasja e të hyrave.** Teknikat e vlerësimit të cilat konvertojnë shumat e ardhshme (psh rrjedhat e parasë apo shpenzimet) në një shumë aktuale (p.sh të skontuar). Matja e vlerës së drejtë përcaktohet në bazë të vlerës së sugjeruar nga pritjet aktuale të tregut për shumat në të ardhmen.
- **Qasja e tregut.** Një teknikë e vlerësimit që përdor çmimet dhe informatat tjera relevante të gjeneruara nga transaksionet e tregut të cilat përfshijnë pasuri identike apo të krahasueshme (p.sh të ngjajshme), detyrime apo grup të pasurive dhe detyrimeve, siç është një biznes.
- **Qasja e kostove.** Një teknikë që reflekton shumat që mund të kërkohen aktualisht për të zëvendësuar kapacitetin e një pasurie (shpesh të referuar si një kosto aktuale e zëvendësimit).

c) (i)	**€m**	**€m**
Konsiderata e transferuar		520
IJK (20% x 450)		90
Vlera e drejtë e interesit të ekuitetit të mbajtur më herët (€520m × 20/40)		260
Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të blera		
Kapitali aksionar	200	
Fitimet e mbajtura	250	(450)
Zëri i mirë (në datën kur është fituar kontrolli)		**420**

(ii)	**€m**
Vlera e drejtë në datën e marrjës së kontrollit (shih pjesën (a))	260
Kosto	(160)
Fitimi në mosnjohjën (largimin) e investimit	**100**